

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 05, datë 27.02.2019

**Për miratimin e “Pasqyrave financiare të
Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
për vitin 2018”**

Në mbështetje të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1” të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, nenit 71, pika 2, të nenit 73, pika 1, dhe të nenit 79, pika 1, pika 4 dhe pika 5 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenin 15, pika 1 dhe pika 5 të Vendimit nr. 56, datë 3.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2018”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e pasqyrave financiare të audituara në Autoritetin Mbikëqyrës dhe në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë si pjesë e raportimit vjetor të dokumenteve financiare.



KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar